



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 25.

Prishtinë, më 14.07.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Valdete Bajrami, Rustem Mustafa, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ilir Deda dhe Time Kadriaj.

Mungoj: Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Slllobodan Petroviq, Arben Gashi dhe Kujtim Paçaku.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahter Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhjet e datës 23.06.2015 dhe 03.07.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

Kryetarja Teuta Sahatqija pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për punë hapi mbledhjen sipas rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja para se të miratohet rendi i ditës, kërkoj nga anëtarët e Komisionit që në Rend dite të shtohet edhe një pik që ka të bëjë me Shqyrtimin e Projektligjit për faljen e borxheve.

Kryetarja konstaton se Komisioni njëzëri miratohet Rendi i ditës me këtë plotësim.

2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e dt. 23.06.2015 dhe 03.07.2015.

Kryetarja konstaton se Procesverbalet e mbledhjes nga dt. 23.06.2015 dhe 03.07.2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja tha se në seancën plenare kemi miratuar shmangien nga Rregullorja për procedim të përshpejtuar të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nuk rregullohet në mënyrë specifike i lejohej secilit shtet veç e veç ta rregullojë.

Në vazhdim ia dha fjalën **Ilir Dedës** pasi që është anëtar edhe në Komisionin për buxhet ta njoftoj Komisionin lidhur me amendamentimin e tij.

Ai tha se Komisioni për buxhet dhe financa kishte formua grupin punues i cili e ka amendamentuar Projektligjin dhe amendamentet janë votuar në Komision, andaj sugjeroj që të shkohet me pako të amendamenteve në votim.

Luljeta Gutaj Veselaj kishte vërejtje sepse nuk është mbështetur projekti i MAP-it prej 2 mil.e 200 mi €, iu kanë hjek 2 Mil dhe kjo do të na nxjerr probleme në punën tonë, nuk e dimë se si është konceptua nga Ministria e financave por kjo ka me reflektua probleme.

Ilir Deda sqaroi duke thënë se një bashkëpartiak i juaj ia ka dorëzua një letër Ministrisë së financave dhe është vendosur që kjo çështje ka me u zgjedh me Ministrin e financave.

Pas diskutimeve Kryetarja konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja tha se Projektligji për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore përcakton procesin kalues nga emetimi analog në atë digjital në Republikën e Kosovës, edhe në Raportin e Progresit digjitalizimi është kërkuar që të mbështetet me ligj.

Lidhur me këtë projektligj ka pas interesim edhe nga organizatat si AMPEK dhe KPM lidhur me amendamentin 10. Kemi vërejtje edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë lidhur me amendamentin 26.

Ilir Deda e konsideron amendamentin 10 si jo kushtetues dhe propozoi që mos të përkrahet sepse nuk është në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së

Kryetarja tha se amendamenti 10 i Komisionit funksional është në kundërshtim me promovimin e konkurrencës.

Amendamenti 26 ndryshon përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës dhe në këtë mënyrë prish bilancin e përfaqësimit të barabartë sa i përket dy rregullatorëve si KPM dhe ARKEP-it.

Po ashtu, edhe Amendamenti 27 paraqet një konflikt të interesit në rast se Komisioni Mbikëqyrës e emëron dhe mbikëqyrë punën e Komisionit Vlerësues.

Pas diskutimeve **Kryetarja konstaton se me shumicë votash nxori këtë;**

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së.

Nga amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk miratohet amendamenti 10, amendamenti 26 dhe amendamenti 27.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për faljen e borxheve me amendamentet e Komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja lidhur me këtë Projektligj tha se sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nuk rregullohet në mënyrë specifike i lejohej secilit shtet veç e veç ta rregulloj, kurse amendamentet e komisionit funksional janë më tepër riformulime.

Lidhur me këtë hapi debatin.

Rrustem Mustafa tha se në krejt botën shlyhen borxhet por jo mos ti paguaj askush. Kompanitë publike futen në borxhe dhe Qeveria duhet tu paguaj atyre njerëzve.

Kryetarja tha se kjo çështje nuk ka të bëjë me fushëveprimtarin e Komisionit.

Pas votimit Kryetarja konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligjit për faljen e borxheve me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

6. Të ndryshme;

Kryetarja në këtë pikë njoftoi se Komisioni për Integritet Evropian i Shqipërisë nuk ka mundur me ardhë për vizitë më herët, andaj na kanë njoftuar se me 21 korrik do të vijë me realizua vizitën në Komisionin tonë.

Senatori Vannino Chiti, i Komisionit për çështje Evropiane në Itali ka pranuar ftesën dhe do të vijë me 18 shtator për takim në Komision.

Kryetare e Komisionit,

Përgatiti:

Njësia për Mbështetje Komisionit

Znj. Teuta Sahatqija